



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 26.

Prishtinë, më 28.07.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Valdete Bajrami, Ilir Deda, Time Kadrijaj, Luljeta Gutaj- Veseli, Arben Gashi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Rustem Mustafa, Vjosa Osmani dhe Slllobodan Petroviq.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-39 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L/-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Të ndryshme.

Kryetarja Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për shëndetin mendor, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj dhe tha se ky projektligj përmban gjithsej 36 nene dhe 42 amendamente të Komisionit funksional.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian, sa i përket çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin mendor, është si vijon:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara;
- Rezoluta e Këshillit, e datës 18 nëntor 1999, për promovimin e shëndetit mendor;
- Vendimi i Këshillit, i datës 26 nëntor 2009, për zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, hapi debatin duke ia dhënë fjalën së pari **Time Kadrijajt**, pasi ishte anëtare edhe në Komisionin funksional për Shëndetësi. Ajo tha se Komisioni funksional ka formuar grupin punues dhe ka amendamentuar projektligjin, duke u thirrur në direktivat evropiane dhe nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk ka të meta, andaj nuk ka nevojë të debatohet më tepër për këtë projektligj.

Pas votimit të anëtarëve lidhur me këtë projektligj, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-25 për shëndetin mendor, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë parlamentare.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj dhe tha se ky projektligj përmban 16 nene dhe 20 amendamente të Komisionit funksional.

Ky ligj është përafëruar me Direktivën e Komisionit 2006/141/EC, të datës 22 dhjetor 2006 për formulën qumështore dhe formulën pasuese që ndryshon Direktivën nr. 1999/21/EC dhe Rregulloren e (EU) nr. 609/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e 12 qershorit 2013 mbi ushqimin e destinuar për foshnjat dhe fëmijët e rinj, ushqimi për përdorime të veçanta mjekësore dhe zëvendësimin e plotë dietal për kontrollin e peshës, që shfuqizon Direktivën e Këshillit 92/52 EEC, direktivat e Komisionit 96/8/EC, 1999/21/EC, 2006/125/EC dhe 2006/141/EC, Direktivën 2009/39/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, si dhe Rregulloret e Komisionit (EC) nr. 41/2009 dhe (EC) nr. 953/2009.

Pasi edhe ky projektligj është amendamentuar nga Komisioni funksional për Shëndetësi, **kryetarja** ia dha fjalën deputetes **Time Kadrijaj**, si anëtare e atij Komisioni.

Ajo tha se edhe për këtë projektligj Komisioni funksional ka formuar grupin punues dhe ka amendamentuar projektligjin, duke u thirrur në direktivat evropiane, dhe nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk ka të meta, andaj nuk ka nevojë të debatohet për të.

Pas votimit të anëtarëve, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-23 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri, me amendamentet e propozuara, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-39 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor dhe tha se ky projektligji përmban gjithsej 29 nene dhe 10 amendamente të Komisionit funksional dhe është pjesërisht i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Acquis të BE-së dhe lidhur me këtë hapi debat.

Pas votimit, **kryetarja** konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-39 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta, me amendamentet e propozuara, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L/-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj dhe tha se përmban 32 nene dhe 11 amendamente të Komisionit funksional.

Fusha e këtij projektligji rregullohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin ndërkombëtar dhe lidhur me këtë hapi debat.

Pas votimit, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L/-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare, me amendamentet e Komisionit funksional, nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

5. Të ndryshme

Kryetarja, në këtë pikë, njoftoi për dy çështje:

- 1.Ftesën e bërë nga Ministria e Administratës Publike për dëgjimin publik lidhur me prezantimin e Draft-strategjisë për modernizimin e administratës publike, që do të mbahet më 29 korrik .
2. Pas rekomandimit tonë lidhur me mos miratimin e amendamentit të propozuar nga z.Nait Hasani për Projektligjin për Letërnjoftimin, që ka të bëjë me futjen e nacionalitetit në letërnjoftim, Komisioni funksional fillimisht e ka përkrahur gjatë amendamentimit, mirëpo pasi që ne nuk e miratuam dhe e kthyem nga ana jonë, Komisioni funksional e ka shqyrtuar prapë dhe e ka parë gabimin, ndërsa tani edhe ata nuk e përkrahën amendamentin e z. Hasani. Raporti me amendamente na është sjellë prapë në Komisionin tonë për njoftim.

Arben Gashi, e konsideroi proceduralisht si punë të kryer, sepse Komisioni nuk mund të merret dy herë me të njëjtën çështje. Po ashtu, theksoi se ka pritur që Komisioni për Legjislacion do të reagojë për atë amendament, sepse është shkelje e rëndë e Kushtetutës identifikimi në letërnjoftim me nacionalitet.

Time Kadrijaj, theksoi se në seancë janë deputetët që me votën e tyre deklarohen se a do ta përkrahin apo jo amendamentin në fjalë.

Kryetare e Komisionit,

Përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Znj. Teuta Sahatqija